

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit


Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për koordinimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK). Vizioni i kësaj strategjie është krijimi i institucioneve transparente, me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe që garantojnë shërbim cilësor dhe të pa-korruptueshëm. Ky vizion është adoptuar në tre qasje, parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuese, ndaj korrupsionit.

Në zbatim të masave dhe aktiviteteve të qasjes ndërgjegjësuese, Ministria e Drejtësisë harton çdo vit Strategjinë e Komunikimit dhe Vizibilitetit në fushën antikorrupsion. Nëpërmjet saj, Ministria synon të arrijë audiencë të ndryshme, brenda dhe jashtë institucioneve shtetërore dhe të ndërtojë një marrëdhënie të re me qytetarët, bazuar në besimin e ndërsjellë për parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit. Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Shtator, 2021

Takim i grupit teknik për diskutimin dhe dakordësimin e Draft-Raportit të Monitorimit të Planit të Veprimit, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, Janar - Qershor 2021

24.09.2021. Në përfundim të procesit të hartimit, konsultimit dhe rishikimit të draft-raportit të monitorimit të Planit të Veprimit, 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, për periudhën Janar-Qershor 2021, Sekretariati Teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, organizoi takimin e prezantimit dhe diskutimit të gjetjeve dhe rezultateve të monitorimit. Takimi u zhvillua me pjesëmarrjen e të gjithë përfaqësuesve të organeve zbatuese të Planit të Veprimit, të cilët u njohën me analizën finale të raportit. Draft-raporti i monitorimit jep të dhëna të zbatimit të aktiviteteve - masave – arritjes së treguesve të performancës dhe progresin për çdo qëllim politikash të strategjisë. Takimi u shoqërua me diskutime për të dhënat e raportit, propozime për hapat e mëtejshëm dhe adresime konkrete për institucionet me qëllim përmirësimin e performancës së zbatimit të Planit të Veprimit, për periudhën në vijim të vitit 2021. Draft-raporti gjashtëmujor do të miratohet në mbledhjen e Komitetit Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, nën drejtimin e Ministrit të Drejtësisë, gjatë muajit Tetor dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.



Takim i Grupit Tematik të Politikë-Bërjes për zbatimin e Qasjes Sektoriale (GMIP) për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik


10.09.2021. Grupi Tematik për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik, komponent i së cilës është edhe fusha e antikorrupsionit, zhvilloi takimin për prezantimin e vetëvlerësimit dhe progresit të zbatimit të Planit Kombëtar të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (eng. Open Government Partnership - OGP), 2020-2022, për periudhën vjetore 2020 dhe Janar-Qershor 2021. Raporti përmban të dhëna dhe progresin e arritur për parashikimet e bëra në këtë plan veprimi. Raporti i Vetëvlerësimit u hartua në përputhje me metodologjinë e monitorimit dhe të analizës së Mekanizmit të Raportimit të Pavarur të OGP, si edhe është konsultuar me OSHC të fushës. Gjetje të raportit për komponentin antikorrupsion – planet e integritetit janë: miratimi i metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit në institucionet e qeverisjes qendrore; miratimi dhe fillimi i zbatimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë (MD); bashkë-bërja e proceseve të hartimit të dokumenteve strategjike në përputhje me parimet e qeverisjes së hapur; procesi në vijim në të gjithë ministrinë dhe varësitë e MD-së për hartimin e planeve të integritetit; dhe komunikimi e informimi i veprimtarisë transparente të MD-së për publikun. Ky raport u vlerësua edhe nga përfaqësues të iniciativës së OGP, nga zyrtarë qendrorë në Kanada.

Paketa e materialeve për mbledhjen është e aksesueshme në këtë link: <https://ogp.gov.al/artikull/raporte-monitorimi-1072> dhe në faqen e OGP: <https://ogp.gov.al/>

Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, zgjidhet anëtare e Komitetit Drejtues të Rrjetit të Agjencive Parandaluese të Korrupsionit (NCPA)

16.09.2021. Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, është një prej vendeve anëtarë themelues të Rrjetit të Agjencive Parandaluese të Korrupsionit (Network of Corruption Prevention Authorities – NCPA, 2018). Rrjeti NCPA është një organizim pranë Këshillit të Evropës, që bashkon autoritete/agjenci me funksione parandaluese kundër korrupsionit nëpërmjet mbledhjes/takimeve, shkëmbimit të informacionit, eksperiencave, praktikave të mira dhe me qëllim krijimin e bashkëpunimeve të mundshme dhe forcimin e përdorimit të mekanizmave AK. Anëtarë të këtij Rrjeti janë 30 shtete. Rrjeti NCPA i zhvillon punimet në mbledhje të seancave plenare çdo 4 muaj. Në mbledhjen e seancës plenare të zhvilluar në datë 16 Shtator 2021, Ministria e Drejtësisë/Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit u zgjodh anëtare e Komitetit Drejtues. Komiteti Drejtues është organi më i lartë i Rrjetit NCPA, që drejton vendimmarrjen, promovon dhe cakton aktivitetet e tij. Anëtarë të Komitetit Drejtues janë 8 vende: Serbi, Francë, Kroaci, Palestinë, Greqi, Marok, Ekuador dhe Shqipëri. Mandati i anëtarësisë në Komitetin Drejtues është dy-vjeçar. Rrjeti NCPA bashkëpunon me organizata në fushën antikorrupsion me qëllim promovimin dhe ndërgjegjësimin e iniciativave antikorrupsion.

Më shumë informacion për Rrjetin NCPA mund të gjeni në këtë link: <https://www.coe.int/en/web/corruption/ncpa-network>



Sesioni i dymbëdhjetë (vijim) i mbledhjes së Grupit të Vlerësimit të Implementimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC)

06-10.09.2021. Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit mori pjesë në punimet e sesionit të dymbëdhjetë (vijim) të mbledhjes së Grupit të Rishikimit të Implementimit të UNCAC, në datat 6-10 Shtator 2021. Fokusi tematik i sesionit të dymbëdhjetë ishin kapitujt IV dhe V të UNCAC, përkatësisht bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rikuperimi i aseteve. Në kuadër të diskutimeve të kapitullit IV, Shqipëria u prezantua si një shembull pozitiv në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe u bë pjesë e panelit në mbledhjen e grupit të ekspertëve. Panelistët nga Shqipëria, ofruan informacion mbi temën “Angazhimi jonë i përbashkët për të adresuar në mënyrë efektive sfidat dhe për implementimin e masave për parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit dhe përforcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar”. Gjatë vitit 2021, në pararendje të punimeve të këtij sesioni, Shqipëria ka dorëzuar pyetësorë të plotësuar pranë UNODC: (1) për konfiskimin e produkteve të veprës penale të korrupsionit, pa një vendim dënimi penal; (2) në lidhje me korrupsionin dhe ndikimin e tij në mjedis; (3) për ekstradimin, ndihmën e ndërsjellë juridike dhe bashkëpunimin ndërkombëtar të autoriteteve ligjzbatuese; dhe (4) për nevojat për asistencë teknike.

Seminari i Grupeve të Interesit për Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) dhe Mekanizmin e Vlerësimit të Implementimit të saj (IRM)

20-22.09.2021. Përfaqësues të Sektorit të Programeve në Fushën Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë, morën pjesë në Seminarin e Grupeve të Interesit në lidhje me UNCAC dhe IRM. Seminari u mbajt në Beograd, Serbi, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC) të angazhuara në fushën e antikorrupsionit në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Moldavi. Në këtë seminar morën pjesë edhe përfaqësues të tre OSHC-ve shqiptare. Ky seminar u organizua nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) në bashkëpunim me Iniciativën Rajonale Antikorrupsion (RAI), si edhe me pjesëmarrjen e ekspertëve të Koalicionit UNCAC. Gjatë seminarit, pjesëmarrësit u përfshinë në diskutime konstruktive për promovimin e përfshirjes së OSHC-ve në procesin e vlerësimit të implementimit të UNCAC, si edhe në atë të parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit. Gjithashtu, seminari i shërbeu rritjes së kapaciteteve të pjesëmarrësve nëpërmjet shkëmbimit të praktikave më të mira dhe trajnimit lidhur me UNCAC dhe mekanizma të tjerë në funksion të luftës kundër korrupsionit. Seminari u zhvillua në kuadër të projektit të përbashkët “Evropa Juglindore – Së bashku kundër korrupsionit” (SEE-TAC), 2020-2023, i financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim.

